



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 060/01-15576/22
Kaçanik, 11.06.2022

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Solemne e Kuvendit të Komunës Kaçanik , për nder të 23 vjetorit, Ditës së Çlirimit të Kaçanikut, mbajtur më 11.06.2022 (e shtunë), me fillim pune në ora 11:00. Mbledhja u mbajt në vendin e quajtur “Kulla e Hasanit”, në fshatin Bob.Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 20 anëtarë.

Nga ekzekutivi i komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, nënkryetari i komunës- Sabedin Vishi, drejtorët e drejtorive komunale; Bahri Selimi, Ramadush Osmani, Zahir Doda, Qamil Stagova, Dardana Dauti, Pranvera Loku-Zharku, Hafize Sallahu, Suhad Dullovi dhe Sali Malsiu. Nga zyrtarët komunal ka qenë Fatlume Guri-Selimi.

Të pranishëm në këtë mbledhje kanë qenë edhe të ftuar të tjerë siç janë : Xhabir Zharku, Tahir Çaka, Hajrush Kurtaj etj.

Mbledhjen e kryesoi, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit, Procesmbajtës, Arbnora Kuka, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndes dhe ju falenderoj për pjesëmarrje në këtë mbledhje solemne të Kuvendit të komunës, për nder të 11 Qershorit, ditës së Çlirimit të Kaçanikut. Në këtë mbledhje është paraparë ky:

REND PUNE

- 1.Fjala përshëndetëse e Kryesuesit të Kuvendit të komunës;
- 2.Fjala përshëndetëse e Kryetarit të komunës, Besim Ilazi; dhe
3. Fjalë përshëndetëse e përfaqësuesve të subjekteve politike në kuvend dhe
4. Fjala përshëndetëse e përfaqësuesve të shoqatave të dalura nga lufta.

- 1.Fjala përshëndetëse e Kryesuesit të Kuvendit të komunës

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, të nderuar anëtarë të Kuvendit, i nderuar Kryetar i komunës, Nënkyetar i komunës, staf ekzekutiv dhe musafir të nderuar.Është paksa ndjenjë e dhe emocion i veçant të drejtosh mbledhjen e kuvendit nga këtu, nga “Kulla e Hasanit”, ngase nga këtu , më datë 11 qershor 1999, Ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të brigadës 162”Agim Bajrami” marshuan drejt qytetit të Kaçanikut për ta çliruar përfundimisht nga okupatori serb. Rruga deri në çlirimin e vendit ishte e gjatë dhe e vështirë, me shumë mund dhe sakrifica, me shumë gjak të dërrshur nga bijt dhe bijat më të mirë të kombit tonë. Të cilët u flijuan që brezat që vijnë të jetojnë të lirë. Andaj për ti nderuar ato , ju ftoj për një minutë heshtje.

LAVDI!

Jemi mbledhur sot në këtë mbledhje solemne për të shënuar një ngjarje të veçantë, 11 qershorin "Ditën e Çlirimit të komunës tonë", ngjarjes ndoshta më të rëndësishme në komunën tonë.

Jemi mbledhur në këtë takim në një vend të veçantë, në vendin ku ishte vendosur Brigada 162 "Agim Bajrami" dhe shtabi i saj, në vendin ku merreshin vendime për jetë e vdekje, në vendin ku shumë plagë lirie kulluan gjak, në strofullën e sigurtë dhe në kull[n] e pamposhtur asnjëherë nga armiku.

Për shumë nga ne që kemi qendruar në këtë kullë gjatë luftës, sot është një ndjenjë e veçantë sepse na sillen në mendjen tonë shumë kujtime, qaste dhimbje për humbjen e shokëve por edhe krenarie për luftën që zhvillohej dhe po fitohej.

Sot kur shënojmë ditën e Çlirimit, ne si organ më i lart vendimmarrës në komunën tonë, nga ky vend i cili simbolizon gjithë luftën dhe sakrificën e këtij populli për liri dhe pavarësi, ne do të kemi më të lehtë marrjen e vendimeve të drejta, vendime që synim kanë mirëqenien për qytetarët tanë. Vetëm duke punuar dhe zhvilluar këtë vend ne mund të përmbushim obligimet tona që kemi për qytetarët tanë.

Urime 11 Qershori, Dita e Çlirimit të Kaçanikut!

Lavdi e përjetshme gjithë atyre që u sakrifkuan për Çlirimin e vendit, nder dhe respekt për të gjithë ata që luftuan dhe kontribuan për të shënuar ne këtë ngjarje të madhe sot.

Kryetari i komunës, Besim Ilazi, Qytetarë të nderuar, të respektuara familje të dëshmorëve, të nderuar mysafirë të pranishëm, I nderuar Kryesues i Kuvendit zoti Murseli, të nderuar asambleist, të respektuar mysafir dhe ju të pranishëm të tjerë

Sot po shënojmë një përvjetor të gëzimit, një përvjetor të lindjes së shpresës dhe jetës për atdheun tonë.

Dita e Çlirimit, 11 Qershor 1999, ishte një ditë e bekuar, një ditë që shënon triumfin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe popullit tonë dhe aleatëve tanë ndërkombëtarë, të prirë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Të nderuar të pranishëm zonja dhe zotërinj

Ju uroj të gjithëve këtë ditë të shumëpritur shekuj me radhë.

Muaji qershor historikisht na bënë pjesë të lavdisë kombëtare e atdhetare, është 10 qershori i vitit 1978 që krijoi platformën politike të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, e shumë qershor të tjerë që kaluan më pas, për të ardhur deri tek qershori i lirisë, qershori i bardhë i Kosovës së gjakosur ndër vite.

Qyteti i Kaçanikut, i përmendur në histori për shumë ngjarje të lavdisë kombëtare, edhe për këtë ditë dha shumë dëshmorë e martirë, e shumë të tjerë dhanë edhe gjymtyrët e trupit.

Shikuar gjeografikisht dhe për nga numri i popullsisë, komuna jonë renditet ndër komunat që i falën shumë dëshmorë e martirë kësaj toke. Janë 85 dëshmorët e qytetit tonë të prirë nga dy komandantët emblematic Agim Bajrami e Qamil Ilazi, që sot pushojnë të qetë në altarin e lirisë, të cilët dhanë më të shtrejtën- jetën e tyre, që ne sot të gëzojmë lirinë. Janë edhe shumë dëshmorë të tjerë anekënd Kosovës, ku lapidarët e tyre, janë dëshmia më e madhe se liria jonë është e shtrenjtë, andaj duhet ta ruajmë me shumë fanatizëm, sepse në themelet e saj është gjaku i tribunëve të atdheut.

Kushtrimi i Komandantit Legjendar, Adem Jashari, jehona e luftës për liri, bëri që djem dhe vajza ti përgjigjeshin këtij kushtrimi dhe i ngjeshën radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

23 vite më pas, Kosova jonë rilindi, u rindërtua, u zhvillua, por Kosovës sonë, ende i duhet përkushtimi dhe angazhimi ynë, lirisë sonë ende i duhet forca jonë për ta ruajtur dhe forcuar. Së bashku të orientuar drejt qëllimeve tona të përbashkëta për një jetë më të mirë për të gjithë pa dallime, për një shkollim cilësor për fëmijët tanë, për një të ardhme të ndritur për secilin qytetar.

Urime për këtë ditë shënuar, urime për arritjet tona të përbashkëta.
Lavdi dëshmorëve të rënë për lirinë e vendit,
Respekt luftëtarëve të UÇK-së
Ju faleminderit

z.Selajdin Troni, I nderuar Kryetar i komunës, Besim Ilazi, i nderuar Kryesues i kuvendit, Kemal Murseli, të nderuar kolegë anëtarë të kuvendit, staf ekzekutiv, shoqata të dala nga lufta , të nderuar të pranishëm.

Kam nderin që në emër të grupi të asambleistëve të Partisë Demokratike të Kosovës në Kaçanik, të ju drejtohem me një fjalë , në këtë ditë solemnee uruese, për këtë ditë të shenjtë të 11 qershorit.

Për këtë ditë të shënuar dhe të rëndësishme për secilin nga ne, kujtojmë sakrificën sublime të luftëtarëve dhe të komandantëve, të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të prirë nga komandanti legjendar Adem Jashari. Kujtojmë sot sakrificën edhe për të gjithë djemt dhe vajzat e Kaçanikut që ishin të rreshtuar në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, nën udhëheqjen e komandantëve Agim Bajrami dhe Qamil Ilazi.

Janë bërë mbi dy dekada nga çlirimi i vendit tonë nga regjimi serb, por sado që koha kalon , dita e çlirimit do të ketë gjithmonë madhësinë e vet për të festuar, por gjithmonë pa e harruar të kaluarën tonë të lavdishme që na solli deri te kjo ditë.

Dita e çlirimit shënon ditën e triumfit të lirisë, por edhe ditën e drejtësisë të kaluar mbi padrejtësitë e mëdha mbi popullin tonë.

Në këtë ditë të shënuar kujtojmë dhe nderojmë të gjithë dëshmorët dhe martirët, të cilët nuk kursyen as jetën, për të realizuar një ëndërr që është bartur brez pas brezi- Lirinë.

Lavdi e përjetshme për ju që nuk kursyet asgjë nga vetja, që ne të frymojmë të lirë.

Urime dita e Çlirimit , nga kjo kull ku do të mbetet simbol i rezistencës kombëtare.

Faleminderit!

z.Agim Mani,Përhëndetje; I nderuar Kryesues i Kuvendit Komunal,I nderuar Kryetar I Komunës së Kaçanikut,të nderuar familje të dëshmoreve,shoqata të dala nga lufta,bashkëlufëtar të UÇK-së,dhe ju gjithë të pranishmit në këtë seancë Solemne të organizuar për hirë të datës historike të 11 qershorit dita e çlirimit të Kaçanikut.

“Janë bërë 23 vjet që Kaçaniku frymon lirshëm!

Kaluam shumë sfida, momente të trishta, të vështira por kishim edhe shumë gëzime.

Si sot, 23 vite më parë është çliruar Kacaniku!

Dita e Çlirimit të Kaçanikut është ditë manifestimi për të kujtuar 11 qershorin e vitit 1999 kur forcat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) hynë në Kaçanik.

23 vjet më parë forcat e UÇK-së kishin hyrë në periferi të qytetit, ndërsa forcat ushtarake e policore serbe kishin filluar tërheqjen, sipas Marrëveshjes së Kumanovës të arritur më 9

qershor të vitit 1999. Dhe më pas nga bazat e tyre në Maqedoni kishin filluar depërtimin në Kosovë forcat tokësore të NATO-s të quajtura forcat paqëruajtëse të KFOR-it, pastaj edhe administrata e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe organizata të tjera ndërkombëtare UÇK-ja kontrollonte pothuajse tërë territorin e Kaçanikut, dhe me datë 11 qershor 1999 ngriti flamurin kombëtar në Kaçanik duke shpallur Kaçanikun qytet të lirë.

Në këtë moment u realizua ëndrra shekullore e popullit të Kosovës. Ishte një ndijenje e pa përshkrueshme emocionale, ne patëm rastin, mundësin dhe privilegjin të jemë pjesë e këtij formacioni ushtarak që të kontribuojmë, sakrifikojmë si një- ushtri e popullit dhe e gjithë qytetarëve të Kosovës, dhe ta përjetojmë nga afër hyrjen e NATO-se në Kaçanik pikërsht nga ky lokacion që jemi tani, me bashkëluftëtarët tonë të qmuar dhe ta shijoj lirinë për herë të parë në qytetin tonë në Kaçanik.

Falënderim dhe mirënjohje përjetë NATO-s, SHBA dhe vendeve demokratike mike, që kurorëzuan këtë aspiratë shekullore dhe kontribuojnë sot për të ndihmuar zhvillimin e pandalshëm të demokracisë, avancimit të proceseve integruese dhe anëtarësimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare.

Ka vështirësi të shumta edhe tani. Andaj ne nuk do të ndalemi së punuari ndershëm për të mirën e Kaçanikut dhe Kosovës. Sepse ky është nderimi më i madh që mund të u bëjmë atyre që u flijuan për çlirimin e qytetit tonë!

Sot është dita për të nderuar rezistencën dhe luftën e drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, sakrificën e shumë brezave shekullore, Komandantin legjendar, Adem Jashari dhe të gjithë martirët e kombit shqiptar kujtojmë edhe Komandantët tanë të brigades 162 "kujtojmë Komandantin Agim Bajrami" dhe "Qamil ilazi".

Kosova e lirë është, faktor paqeje, stabiliteti dhe siguri në rajon, meriton të jetë anëtare e NATO dhe liberalizimi i vizave për qytetarët e saj është një domosdoshmëri, që duhet të ndodhë sa më parë.

Datat si 11 Qershori, na bëjnë të reflektojmë në punën tonë të përditshme, ashtu që të mos e devijojmë rrugën të cilën e kanë trasuar dëshmorët, atë për liri e bashkim.

Qytetarë të Kaçanikut, urime Dita e Çlirimit!

Znj. Ardita Rrahmani, I nderuar kryetar i komunes,
I nderuar kryesues I kuvendit,
I nderuar z. Ramajli, z. Caka
Ekzekutiv I komunes,
I nderuar perfaqesues I Organizatave te dalura nga Lufta,

Familje te deshmoreve,
te nderuar kolege asambleist,
qytetare dhe gjithë ju te pranishem.

“Te gjithë dhan dicka, por dikush I dha te gjitha”.

Nuk ka shprehje tjeter qe mund te e pershkruaj me mire dashurine per atdheun.

Nuk ka shprehje tjeter as qe e tregon cmimin e lirisë.

Ditet e lavdise se perjetshme te trasuara deri me vetflijim jane ditet me te cilat sot mburremi para vetes e karshi botes se sa e lavdishme ishte lufta e jone kundrejt okupatorit ogurzi.

Ideali I clirimit te atdheut ishte emeruesi I perbashket I ushtareve, heronjeve e veteraneve te Ushtrise Clirimtare te Kosoves, emerues ky qe qe u be krenari e cdo shqiptari kudo qe jeton e flet shqip.

Flijimi I familjes Jashari nuk eshte unik vetem ne historine e kombit shqiptar, ajo vazhdon te mbetet unike edhe nder kombe te tjera, sepse ishte ky akt qe frymezoi me mijera te ri e tee reja qe ti bashkohen radheve te Ushtrise Clirimtare te Kosoves.

Emri I Adem e Hamze Jasharit, u bene busulle orientimi drejt konsolidimit te shtetit me te ri ne bote, dhe reference e frymezim brezash tash e 24 vite.

Lavdi dhe perjetesi per komandantin Adem Jashari, familjen e tij dhe gjithë deshmoret e kombit.

z.Ekrem Livoreka, I nderuar Kryesues, i nderuari Kryetar, te nderuar asambleist i nderuar Zharku, Kurtaj OVL-UCK-se.

Ushtria Clirimtare e Kosoves e udhehequr nga komandanti legjendar Adem Jashari ishte arritja me kulmore ne historin tone e cila nderroj rrjedhen e historis tone, ajo vulosi fillimin e luftes per clirimin e Kosoves, por edhe fitoren e kesaj lufte. Ndersa familja Jashari u be shembulli me kuptimplote i sakrifices dhe i fljimit per lirinë e saje.

Sot kur kujtojme 23-vjetorin e clirimit te Kacanikut, rrugën e lavdishme të UCK-së, Brigadën 162 Agim Bajrami dhe sakrificat shekullore të burrave dhe grave te kësaj treve historike ne përpyekje sublime të tyre per clirimin e Kosoves dhe viseve Shqiptare.

Brigada 162 Agim Bajrami ne luften clirimtare ka dhen 86 dëshmorë të lirisë, në mesin e tyre edhe 2 komandant të brigadës: Agim Bajrami dhe Qamil Ilazi dhe veprimtarin e qeshtjes kombëtare Ismail Raka.

Lavdi e perjetshme gjithë të rënve për lirinë e Kosoves rrespekt dhe nder te gjithë veteranëve dhe invalidëve të luftës të cilët kontribuan per kete dite qe ne sot po e gezojme.

Urime 11 Qershori dita e clirimit te gjithë qytetarve te Kacanikut.

z.Agim Çaka, I nderuar Kryetar

I nderuar kryesues

Të nderuar veteranë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

Përfaqesues të familjeve të dëshmorëve

Të nderuar të pranishëm

Jemi sot këtu të gjithë së bashku në një vend shumë të veqantë dhe poashtu në një datë shumë të veqantë.

Pikërisht në këtë vend, para 23 viteve, shumë breza ishin mbledhur për të njejtin qëllim.

Mendjen top e pushkën në krah për të zhvilluar një luftë të pabarabartë me armikun I cili kishte filluar që mos të kursej të gjitha metodat më çnjerzore për të na gjuhëzuar, ndjekur e përndjekur deri në nivelin e gjenocidit, që në këto troje kosovarët të ishin vetëm një hije e së kaluarës.

Pikërisht në këtë vend, para 23 viteve frymonte liria, ushtonte kënga, zihej e gatuhej për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

Qyteti në këtë kohë ishte tërësisht I bllokuar.

Nuk kishte gjallëri pa njerëz.

Pa femijë nëpër shkolla.

Pa të rinjë nëpër lokale e pa puntorë nëpër vendet e tyre të punës.

Për dallim nga qyteti, malet ishin streha e lirisë, malet ishin ushtima e lirisë.

Këto male rreth nesh ishin përplot ushtarë të UÇK-së, të gatshëm për luftë, të gatshëm për sakrificë deri në vetëflijim.

Ajo që bënë brezat tanë nuk ishte e lehtë.

Ajo që bënë familjet tona nuk ishte e lehtë.

Të vetëdijshëm për një luftë të pabarabartë ndaj armikut, por të vetëdijshëm se kjo ishte toka e tyre dhe të betuar se do ta mbronin deri në frymën e fundit, vëllezërit tanë, motrat, nënat e baballarët tanë u rreshtuan në frontin e rezistencës të bindur se liria vetëm mund të vononte dhe se ajo do të vinte patjetër.

Falë angazhimit gjithë populllore, dikush më shumë e dikush më pak

Dikush me pushkë e dikush pa të

Dikush duke luftuar e dikush duke ndihmuar

Arritëm që më në fund, një brez të cilët lirinë e kishim ëndërruar çdo ditë sepse ajo ishte që na mungonte më së shumti, më në fund ta shijojmë e ta përjetojmë.

Por, ne sot këtu, edhe ata që do të vijnë pas nesh, çdo ditë duhet ta mendojmë lirinë, ta respektojmë dhe ta çmojmë atë.

Ajo nuk erdhi lehtë, ajo nuk erdhi vet, atë nuk na e fali kush.

Ajo u pagua shtrenjtë, për të u derdh shume gjak, madje edhe gjak fëmijësh.

Prandaj themi që'' Liria ka emër''

Dikush luftoi për të por dikush edhe derdhi gjakun.

Prandaj kemi dëshmorë të cilët janë themeli I lirisë.

Sot, ngado që shkojmë na percjellin bustet, lapidarët e përmendoret të cilat pasqyrojnë heroizmin e lavdishëm të tyre.

Ngado që shkojmë kemi varreza të dëshmorëve para të cilëve përulemi për veprën e tyre heroike deri në vetflijim.

Të nderuar të pranishëm,

Për të arritur deri te liria u sakrifkuan breza të tërë.

Nuk guxojmë ne sot, apo gjeneratat pas nesh ti ngatërrojnë meritoret dhe jomeritorët.

Prandaj duhet të shkruhet historia, prandaj duhet të shkruhet nga ata të cilët dijnë ta shkruajnë historinë dhe që ajo histori pastaj të lexohet e të mësohet **mirë dhe drejtë nga brezat e rinj.**

Lavdi dëshmorëve të lirisë!

Lavdi luftës së UÇK-së!

Respekt familjeve të dëshmorëve!

Respekt Veteranëve të UÇK-së!

Respekt për çdo pikë gjaku të derdhun për Kosovën e lirë!

Gëzuar 11 Qershori Dita e Çlirimit të qytetit tone.

z.Xhabir Zharku, I nderuar Kryetar i komunës, **z.Illazi**, të nderuara familje të dëshmorëve, i nderuar Kryesues i Kuvendit, **z.Murseli**, të nderuar asambleist, të nderuar pjesëmarrës.

Jemi tubuar sot , për të kujtuar këtë ditë madhështore Jemi gjeneratë me fat.

Rrënjët e UÇK-së janë që nga 10 qershori i 1878, ku në Prizren u mbledhën. U mor një vendim që të ketë një territor ku flitet shqip.

Ajo atëherë nuk mund të bëhej, edhe më vonë nuk mund të bëhej sepse nuk ishte koha. Terrori ishte i tmerrshëm. A ka terror më të madh se të mbysin fëmijët, duke djegur, duke prerë nënat dhe nxjerrë fëmijët nga barku. Duhet t'i tregojmë këtë gjeneratave të reja. Pa mbrojtje nga askush shqiptarët organizohen prap. Ishte mund i madh nga prindërit tanë. Ne ju rrekëm mësimet e dikush ilegales. Ishin vite të rënda. Shqiptarët morën guximin kundër jugosllavisë. Që nga ato vite organizohemi deri në epokën e UÇK-së. Në mbledhjen e Dejtonit u kuptua qartë se popujt të cilët nuk luftojnë nuk marrin asgjë , por do të shuhën.

Duke marrë këtë mesazh, njerëzit e sakrificës filluan organizimin e UÇK-s, e cila ushtri kishte rrënjët e veta që nga "Lidhja e Prizrenit".

Rrënjët e reja i kishte vendosur Regjep Mala dhe Nuhi Berisha.

Me aq sa ditëm dhe mundëm i dolëm atdheut zot.

Kosova ishte e gjitha në luftë por jo të gjithë luftëtarë të lirisë. Shtëpitë ishin kazerma të UÇK-së, por luftëtarët e lirisë e kishin barrën më të rëndë.

Çdo kujt t'i jepet merita që i takon.

UÇK ishte këtu. Janë antikombëtarë ata që thonë se Kosovën e ka çliruar NATO. Jemi falenderues ndaj NATO-s deri në vdekje, por ne ishim këtu. Ne bëmë luftën këtu dhe sollëm lirinë, për ta gëzuar i gjithë populli. Jam shumë i emocionuar dhe shumë i gëzuar kur i shoh të gjitha subjektet politike bashkë.

Si ish komandant i Brigadës , ju ftoj të jeni gjithmonë bashkë.

Ju asambleistët përfaqësoni në mënyrën më të mirë votën e popullit, ju duhet t'a forconi shtetin. Vetëm kështu mund të jemi ballëhapur ndaj dëshmorëve të cilët luftuan për këtë ditë.

Ne duhet të punojmë dhe të zhvillojmë vendin tonë.

Ju uroj ditën e Çlirimit të gjithë qytetarëve.

Edhe pas 23 vjet nga Çlirimi i Kosovës, komandantët tonë luftojnë me pendë, që t'i mbrojnë çlirimtarët tonë që padrejtësisht akuzohen në Hagë.

Komandanti Kudusi Lama ka botuar një libër "Ushtria Çlirimtare përballë shpifjeve" dhe në shenjë respekti disa libra do t'i shpërndajë këtu.

Procesmbajtës
Arbnora Kuka


